



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2021:282814  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05730539

**E.nr.773/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorëve: A.I. etj, të cilët i përfaqëson av Qendrim Reçica nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, dhe shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 24.05.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përbarimore në lëndën **E.nr.773/22**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.773/22, të datës 01.09.2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, te pagave jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit 2021:282814, të datës 03.05.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 12.12.2022, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,419.10 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.773/22, më datë 24.05.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**